

HAP PAS HAPI

Trajnimi avansues për motra edukatore që punojnë me fëmijë të moshës 0-3 vjecare

Qëllimet e Programit

Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit përfitojnë:

- Njohjen e *koncepteve* të përgjithshme *filozofike* dhe bazën teorike të *programit me në qendër fëmijën*
- Njohjen e *praktikave të përshtatshme zhvillimore* që mbajnë parasysh fëmijën në tërësi si qenie intelektuale, sociale dhe emocionale
- Njohje mbi zhvillimin e trurit të fëmijët e moshës 0-3 vjecare
- Aftësi për organizimin e *mësimit të individualizuar*, që nënkupton respektimin e potencialit zhvillimor të secilit individ në aspektin psiko-social, fizik, shoqëror, gjinor
- Aftësi për krijimin e mundësive për liri të shprehjes, të drejtën për zgjedhje dhe vendosjen për përgjegjësi që reflektojnë *frymën demokratike në klasë*
- Aftësi për *planifikimin e rutinave ditore*
- Shkathtësi për *vëzhgimin e fëmijës dhe vlerësimin e efekteve të punës në klasë*
- Ide për krijimin e një *ambienti stimulues për mësimnxënie aktive*
- Njohuri për *përfshirjen e familjes në realizimin e programit*

Përmbajtja e trajnimit fillestar për klasën e parë

Kush jemi ne në relacion me fëmijët, qasja gjithpërfshirëse në zhvillimin e foshnjeve dhe fëmijëve, principet e punës, praktikat e përshtatshme zhvillimore, zhvillimi i fëmiut si individ – temperamentit, dallimet individuale, roli jonë në zhvillimin e fëmijëve, vendosja e besimit, zhvillimi i trurit të foshnjës, loja sensorike, si mësojnë foshnjat, të mësuarit përmes lojës, vëzhgimi, ambienti stimulues, të mësuarit përmes rutines, mbarimi i librave dhe lodrave, familja dhe komuniteti.

Grupi i synuar

Ky program u dedikohet motrave edukatore të cilat punojnë me fëmijë të moshës 0-3 vjeçare, të punësuarve në administratë arsimore, zyrtarëve të arsimit, pedagogëve, profesorëve dhe studentëve të Universitetit, si dhe trajnerëve të programit.

Forma e organizimit/Kohëzgjatja

Trajnimi avansues për motra edukatore realizohet me anë të një trajnimi pesë ditësh, që përfshin gjithsej 40 orë. Ky trajnim pasohet me 4 punëtori njëditore gjatë një viti akademik. Me qëllim që të përcillet puna në kontinuitet dhe të punohet sa më shumë në cilësi të punës çdo muaj parashihen monitorime në klasë.

Certifikimi

Kusht për certifikim është pjesëmarrja 90% në trajnim.